

# Kartela e çdo pacienti me astmë duhet të ketë:

1. Të paktën 1 spirometri në vit.
2. Pyetësin për kontrollin e astmës të plotësuar në çdo vizitë. Pyetësi mban datën e vizitës së përshkruar në kartelë. Një pyetësor bosh për të vlerësuar kontrollin e astmës në vizitën e ardhshme.
3. Pyetësin për identifikimin e faktorit shpërthyes të astmës, të plotësuar.
4. Planin individual për çdo pacient me astmë të përshkruar në ditën përkatëse të konsultës në kartelën e pacientit ose gjindet një kopje e tij.

Pacientit i jepet “Plani individual” si dokument më vete dhe informohet që ta sjellë çdo herë me vete në vizitë ose ta ketë foto në celular dhe të mund ta tregojë në vizitën e radhës.

Në çdo vizitë në datën përkatëse, te kartela e pacientit mjeku dokumenton në përshkrimin e konsultës që pacienti vazhdon të ketë të njëjtin plan ndjekjeje dhe në rast ndryshimi përshkruan ndryshimet përkatëse dhe pasqyron këtondryshime te dokumenti i planit të ndjekjes që pacienti e merr me vete në shtëpi.